



Republika e Kosovës
Komuna Drenas (Glllogoc)
Kuvendi Komunal
Nr. 02-400/01-25751 dt. 31.05/ 2023



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40, pika 40.2, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 16, pika 11 të Ligjit Nr. 08/L-198 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë: 26.05.2023 e cila vazhdoi me dt. 31.05.2023 miratoi këtë:

VENDIM

Neni 1

Me aprovimin e këtij vendimi shfuqizohet vendimi Nr. 02-400/01-18560 i datës 24.04.2023 i Kuvendit të Komunës së Drenasit për rialokimin e mjeteve financiare.

Neni 2

Propozohet rialokimi i mjeteve financiare brenda nënprogramit Shëbimet Kulturore (85001) dhe kategorisë së Shpenzimeve Kapitale (30) në shumën 300,000.00 euro.

Neni 3

Rialokimi i mjeteve bëhet nga projekti "Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës, Muze, Arkiv, Bibliotekë, Teatër, Salla Filmi, Galeria e Arteve) Glllogoc, Tërstenik, Komoran", kodi 53732, nga burimet e fondeve Grande Qeveritare (10) në shumën 150,307.00 euro dhe nga të Hyrat Vetanake (21) në shumën 149,693.00 euro në projektin "Ndërtimi i stadionit- faza e dytë", kodi 89114, burimi i financimit Grande Qeveritare (10) në shumën 150,307.00 euro dhe të hyra vetanake (21) në shumën 149,693.00 euro.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Milaim Hajdari

Arsyetim

Komuna e Drenasit më date 24.04.2023 ka nxjerrë vendimin nr. 02-400/01-18560 për rialokimin e mjeteve financiare, mirëpo Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal ka kërkuar nga ana e Komunës së Drenasit që të specifikohen saktë burimet e financimit. Me këtë rast në përputhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Kuvendit të Komunës së Drenasit I propozohen ndryshimet e lartëcekura.

Me aprovimin e këtij vendimi shfuqizohet vendimi Nr. 02-400/01-18560 I datës 24.04.2023 I Kuvendit të Komunës së Drenasit për Rialokimin e Mjeteve Financiare.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

MINISTRIA E FINANCËVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

11/11/2023
1198-2/2023
30.06.23
PRISHTINE/A

30.06.2023
660-455/6

Për:	Ramiz Lladrovi, Kryetar i Komunës së Drenasit
Kopje:	Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë: 142/2023
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Bora Duli, Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Drenasit
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Lladrovi,

I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimin Nr. 02-400-25750/23, për rialokim të mjeteve financiare</i>
<i>Vendimin Nr. 02-400-25751/23, për rialokim të mjeteve financiare nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</i>
<i>Të miratuar në datë 26.05.2023</i>
<i>Të parashtruara për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në datë 31.05.2023.</i>
<i>Të dërguara për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në datë 06.06.2023</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Hanit të Elezit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Me anë të aktit administrativ komunal që është subjekt i shqyrtimit, Komuna e Drenasit ka synuar rialokimin e mjeteve financiare.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se procesi i ndryshimeve të mjeteve financiare të ndara për projekte kapitale në kuadër të nën-programeve evidentohet edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 (këtej e tutje referuar si 'Ligji i Buxhetit 2023'), Udhëzimet Administrative Nr. 04/2029 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2019 për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritetizimin e Projekteve Kapitale (këtej e tutje referuar si 'Udhëzimet Administrative').
3. Sipas Ligjit të Buxhetit 2023, më konkretisht, nenit 15, paragrafi 1, transferi i shumave të ndara buxhetore bëhet në përputhje me nenin 30 të LMFPP-së, në nivel të nën-programit buxhetor dhe kategorisë së shpenzimeve.

4. Kështu, në kuptim të ndryshimeve në shumat e ndara buxhetore, neni 16, paragrafi 11 i Ligjit të Buxhetit 2023 përcakton se Komunitat mund të transferojnë dhe/ose alokojnë mjetet nga projektet kapitale, si në vijim:

Neni 16

Ndryshimet në shumat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën-programeve

11. Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese sjell rezultate të transferimeve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrjet vetinake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMPK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal, kurse në rastin e FZHM-së ndryshimet në shumat e ndara buxhetore duhet të aprovohen nga Bordi i FZHM-së. Ndryshimet e bëra të parapara me këtë nen regjistrohen në SIMPK nga Ministri.

5. Logjika e ndjekur me këtë dispozitë është se transferi/rialokimi brenda nën-programeve mund të realizohet vetëm atëherë kur kemi aprovim paraprak nga Kuvendi Komunal.
6. Nisur mbi premisat e këtij argumentimi, mbetet evidente se organizatat buxhetore i ka transferuar/rialokuar mjetet nga një nën-program në tjetrin. Përkundër kësaj, realizimi i suksesshëm i një procesi të tillë karakterizohet me detaje teknike buxhetore për të cilat organizatat buxhetore bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Buxhetit.
7. Në këtë kuptim, Ministria konstaton se aktet administrative të Komunitetit të Drejtësisë janë në përputhje me legjislacionin në fuqi - mirëpo realizimi i suksesshëm kushtëzohet me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lëndëve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunitetit të Drejtësisë dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të nevojshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

****Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferimeve përkitas me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferimeve****